



BACHELOR

INFORMATIKË BIZNESI

NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU

Pse ky program studimi?

Programi Bachelor në "Informatikë Biznesi" në bashkëpunim me **BOKU**, ofron formim dhe kompetenca akademike të integruara të shkencave kompjuterike, administrimit të biznesit dhe shkencave ekonomike.

Programi ofron formim të integruar teorik dhe praktik, me qëllim pajisjen e studentëve me aftësi të nevojshme për të projektuar, zbatuar dhe menaxhuar sisteme informacioni që mbështesin funksionimin modern të bizneseve.

Me një kurrikulë të harmonizuar me standardet europiane, programi mbështetet në një strukturë të balancuar që përfshin planifikimin, projektimin, zhvillimin, zbatimin, funksionimin, optimizimin dhe përdorimin ekonomik të sistemeve të informacionit dhe komunikimit.


Diplomë që njihet ndërkombëtarisht



Think... Code... Transform!

Përshkrimi i programit

Programi Bachelor në Informatikë Biznesi ofron një program ndërdisiplinor i cili i jep rëndësi si njohurive teorike ashtu edhe zbatimit praktik, veçanërisht në fusha si zhvillimi i softuerëve, menaxhimi i të dhënave, sistemet e ndërmarrjeve dhe strategjitë e transformimit digjiital. Programi zhvillohet në tre vite studimi (180 ECTS) dhe ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Departamenti Matematikë dhe Informatikë. Ky program përfaqëson një shembull të mënyrës se si arsimi modern mund të ndërtojë ura midis inovacionit teknologjik, parimeve tradicionale ekonomike dhe menaxhimit të biznesit.



Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit në Informatikë Biznesi kanë një profil të gjerë profesional dhe janë të aftë të kontribuojnë në sektorë të ndryshëm, si:

- **Projektues i Sistemeve Inovative** – Krijimi dhe dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve digjitale inovative; programues dhe analistë sistemesh.
- **Zhvillues Sistemi/ Inxhinier Softuerësh** – Dizenjimi dhe implementimi i aplikacioneve softuerike të biznesit dhe sistemeve të ndërmarrjeve të agrobiznesit dhe më gjerë.
- **Administrator i Bazave të të Dhënave & Analist të Dhënash** - Menaxhimi dhe sigurimi i të dhënave; analizimi i të dhënave të biznesit për të mbështetur vendimmarrjen.
- **Specialist në E-Business ose E-Government** – Zhvillimi dhe menaxhimi i platformave online dhe shërbimeve digjitale.



Patrik Nasufi

Software Developer,
CEO & Founder at Vatra

Kam studiuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe e rekomandoj programin Informatikë Biznesi, pasi ofron një kombinim të balancuar midis njohurive teorike dhe aplikimeve praktike në fushën e teknologjisë dhe biznesit. Programi është i orientuar drejt kërkesave të tregut të punës, stafi akademik është i përkushtuar dhe me ekspertizë në IT dhe ekonomi, ndërsa studentëve u ofrohen mundësi reale për zhvillim profesional.



Aleksandro Vogli

HR Solution Specialist,
Boston Consulting Group

Studimet në Informatikë Biznesi në UBT më kanë pajisur me njohuri të thelluara mbi integrimin e informatikës me proceset e biznesit, si dhe me aftësi analitike dhe teknike në përpunimin e të dhënave dhe mbështetjen e vendimmarrjes. Duke zhvilluar zgjidhje digjitale, analizuar të dhëna dhe kontribuar në optimizimin e proceseve të biznesit, kam ndërtuar një profil profesional të qëndrueshëm dhe të suksesshëm.



Rinald Shehaj

Software Engineer
Albania Software House

Studimet në Informatikë Biznesi më kanë pajisur me aftësi të avancuara analitike dhe teknike, të cilat i zbatoj në punën time si inxhinier softwere dhe zhvillues web. Përmes integritit të teknologjisë së informacionit me proceset e biznesit, zhvilloj aplikacione dhe zgjidhje digjitale që mbështesin funksionimin dhe optimizimin e biznesit.



Xhesjana Stambolliu

Software Developer,
Lufthansa Industry Solutions

Studimet në Informatikë Biznesi kanë luajtur një rol thelbësor në formimin tim profesional, duke më pajisur me bazat e forta në programim, sisteme dhe arkitekturë softuerike. Falë këtij formimi, kam ndërtuar një karrierë si Software Developer në zhvillimin e aplikacioneve dhe shërbimeve backend të besueshme. Specializimi im në .NET Core dhe arkitektura microservices mbështetet drejtpërdrejt në njohuritë e fituara gjatë studimeve.

Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë kompetenca në:

- Dizenjimin dhe në zhvillimin e sistemeve për mbledhjen, menaxhimin dhe analizimin e të dhënave të lidhura me sistemin e agrobiznesit.
- Zhvillimin e sisteme të menaxhimit financiar, përfshirë mjetet për sigurimin dhe vlerësimin e riskut financiar.
- Integrimin e teknologjive të avancuara të informacionit në proceset e menaxhimit të biznesit.
- Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e platformave digjitale, me fokus nxitjen e inovacionit në ekonomi.

Këto aftësi janë të përshtatura me nevojat aktuale dhe afatgjata të tregut të punës.

PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

LËNDËT BAZË

Matematikë
Statistikë
Teoria e Probabilitetit
Mikroekonomi
Makroekonomi

LËNDËT KARAKTERIZUESE

Hyrje në Informatikë
Algoritmikë dhe Strukturë
Programim Python
Database dhe Menaxhim
Modelim Biznesi
Programim Web
Teknologjitë .NET
Hyrje në AI
Bazat e Ekonometrisë

TË TJERA

Kontabilitet
Financë
Marketing
Menaxhim Publik
Bujqësi Inteligjente, GIS
Menaxhim Agrobiznesi
Praktikë Profesionale
Temë Diplome

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme.

Mundësi Punësimi:

- Administratën publike
- Sistemin bankar dhe institucione financiare
- Kompanitë e telefonisë celulare, mediave televizive
- Bizneset private, kompani konsulence
- Industritë e Agrobiznesit dhe sektorin agroushqimor
- Organizata ndërkombëtare dhe OJF

Të dhënat e programit

Niveli i studimit

Cikli i parë, Bachelor

Titulli akademik

Bachelor në Informatikë Biznesi

Kohëzgjatja

3 vite akademike / 6 semestra

Kredite

180 ECTS

Forma e studimit

Me kohë të plotë

Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

Kuota studimi

100 studentë

Përfundimi i studimeve


Provim formimi / Temë diplome



Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore, zhvillimin rural dhe agrobiznesin digjital duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU.



Për më shumë informacion vizitoni:

www.ubt.edu.al

info@ubt.edu.al

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH MASTER SHKENCOR

Pas diplomimit, studentët kanë mundësi të vazhdojnë studime të ciklit të dytë Master Shkencor në Informatikë Biznesi, Financë, Ekonomiks, Menaxhim Biznesi Digital ose fusha të afërta, brenda dhe jashtë vendit. Programi siguron një bazë të fortë teorike dhe metodologjike për vazhdimësi akademike.

FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti_bujqesor_tiranes
fea_ubt



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare
Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit - UBT- faqja zyrtare

Për jetën dhe të ardhmen...